

VITI I TRETË

Drejtimi: Kompjuterikë

Semestri i V.

Nr.	Lënda	ECTS	Orët	Lloji
1.	Mikroprocesor dhe mikrokontroller	6	(2+0+2)	O
2.	Sistemet Opreative	6	(2+0+2)	O
3.	Inxhinieria softverike	6	(2+0+2)	O
4.	Dizajni dhe analiza e algoritmeve	6	(2+2+0)	O
5.	Lëndë jo teknike:	6		Z
	1. Makroekonomia		(2+2+0)	
	2. Mikroekonomia		(2+2+0)	
Gjithsejtë:		30	20	

Semestri i VI.

Nr.	Lënda	ECTS	Orët	Lloji
1.	Programimi në Internet	6	(2+0+2)	O
2.	Lënda zgjedhore 1	6		Z
3.	Lënda zgjedhore 2	6		Z
4.	Punim diplome	12		O
Gjithsejtë:		30		

Lëndë zgjedhore 1 dhe 2:

1. Programimi i distribuar (2+0+2) 6 ECTS
2. Web shërbimet (2+0+2) 6 ECTS
3. Grafika kompjuterike (2+0+2) 6 ECTS
4. Telekomunikacionet (3+1+1) 7 ECTS
5. Bazat e inteligjencës artificiale (2+1+1) 6 ECTS
6. Sistemet e ndërfutura (2+0+2) 6 ECTS
7. Lista e lëndëve nga drejtimet tjera të sem. veror

Syllabusi

Universiteti i Prishtinës

Departamenti/Fakulteti/Njësia akademike: Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike

Titulli i kursit (lëndës mësimore) : Mikroprocesorët dhe mikrokontrollerët

Niveli dhe lloji i kursit: Bachelor / zgjedhore

Viti i studimeve dhe semestri: Viti i tretë / Semestri i V-të

Numri i orëve në javë: 2+1+1

Kodi ose shifra e lëndës: 258

Vlera në kredi ECTS : 6

Koha/lokacioni (termini i mbajtjes së ligjëratisë dhe salla)

Mësimdhënësi i kursit: Detajet kontaktuese :zyra/telefoni/e-mail dhe termini i caktuar për bisedë me studentë

Lavdim Kurtaj,

lavdim.kurtaj@yahoo.com

+377 (0) 44 199 839 (së pari dërgo një SMS)

Kab. 708

Qëllimet e kursit(modulit):

- Njohja me detalet e pjesës harduerike të kompjuterit
- Përdorimi i mikroprocesorit/mikrokontrollerit në aplikime të ndryshme
- Konceptet bazike për mikrokontroller
- Njohja me arkitekturën e mikrokontrollerëve të familjes 8051
- Njohja me sistemet për zhvillimin e softuerit
- Programimi i mikrokontrollerëve në assembler, C, Basic
- Programimi dhe shfrytëzimi i njësive periferike

Rezultatet e pritura të nxënies

Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që:

1. Të njoh strukturën e sistemeve mikroprocesorike me të cilat do të takohet
2. Të projektojë sisteme mikroprocesorike bazike për aplikime konkrete
3. Të shkruaj programe për aplikime konkrete
4. Të detektojë problemet në sistemet mikroprocesorike

Metodologjia e mësimdhënjes: (p.sh.ligjërata,seminar,diskutim,punë në grupe,etj)
Ligjeratë, diskutim.

Literatura bazë :

D. V. Hall, *Microprocessors and digital systems*, McGraw-Hill
S. MacKenzie, *The 8051 microcontroller*, Prentice-Hall
Manuale të prodhuesëve për mikroprocesor dhe mikrokontroller

Plani i detajizuar i mësimit për një semestër:

Java e parë:

Motivimi dhe njohja me sistemet mikroprocesorike

Literatura: S. MacKenzie, *The 8051 microcontroller*, Prentice-Hall, faqe 1-16

Java e dytë:

Qarqet logjike për projektimin e sistemeve mikroprocesorike

Literatura: D. V. Hall, *Microprocessors and digital systems*, McGraw-Hill, faqe 17-134
Manuale të prodhuesëve (linqe në Internet)

Java e tretë:

Sistemi mikroprocesorik dhe detalet e komunikimit në mes njësave
(diagramet kohore)

Literatura: D. V. Hall, *Microprocessors and digital systems*, McGraw-Hill, faqe 135-290,
451-464
S. MacKenzie, *The 8051 microcontroller*, Prentice-Hall, faqe 287-302
Manuale të prodhuesëve për mikroprocesor dhe mikrokontroller

Java e katërt:

Struktura e brendëshme e 8051 dhe variantat e prodhuesëve të ndryshëm

Literatura: S. MacKenzie, *The 8051 microcontroller*, Prentice-Hall, faqe 17-42
Manuale të prodhuesëve për mikrokontroller te familjes 8051

Java e pestë:

Njohje me sistemin zhvillimor

Literatura: Manual i Sistemit Zhvillimor 8051
S. MacKenzie, *The 8051 microcontroller*, Prentice-Hall, faqe 181-228

Java e gjashtë:

Bashkësia e instruksioneve

Literatura: S. MacKenzie, *The 8051 microcontroller*, Prentice-Hall, faqe 43-62
Manuali i mikrokontrollerit 8051

Java e shtatë:

Portet për hyrje/dalje dhe komunikimi me periferi

Literatura: S. MacKenzie, *The 8051 microcontroller*, Prentice-Hall, faqe 193-228

Vlerësimi i parë intermediar

Java e tetë:

Programimi në assembler

Literatura: S. MacKenzie, The 8051 microcontroller, Prentice-Hall, faqe 117-154
Manuale të assemblerëve

Java e nëntë:

Tastatura dhe displei

Literatura: S. MacKenzie, The 8051 microcontroller, Prentice-Hall, faqe 193-228
Manuale të komponenteve

Java e dhjetë:

Struktura e programeve. Diagrami i gjendjeve

Literatura: S. MacKenzie, The 8051 microcontroller, Prentice-Hall, faqe 155-180

Java e njëmbëdhjetë:

Funksionimi dhe programimi i tajmerëve

Literatura: S. MacKenzie, The 8051 microcontroller, Prentice-Hall, faqe 63-80

Vlerësimi i dytë intermediar

Java e dymbëdhjetë:

Interraptet (ndërprerjet) - gjenerimi dhe procesimi

Literatura: S. MacKenzie, The 8051 microcontroller, Prentice-Hall, faqe 97-116

Java e trembëdhjetë:

Komunikimi serik

Literatura: S. MacKenzie, The 8051 microcontroller, Prentice-Hall, faqe 81-96

Java e katërmbëdhjetë:

Shndërrimi A/D dhe D/A

Literatura: S. MacKenzie, The 8051 microcontroller, Prentice-Hall, faqe 193-228

Java e pesëmbëdhjetë:

Programimi në gjuhë të larta programuese

Literatura: Manuali i BASIC për 8051
SDCC në Internet

Metodat e vlerësimit:

Vlerësimi i parë:	10 %
Vlerësimi i dytë:	10 %
Detyrat e shtëpisë:	10 %
Ushtrimet laboratorike:	40 %

Provimi final:	30 %
Total:	100 %

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Vlerësimi i parë, Vlerësimi i dytë, Detyrat e shtëpisë dhe Ushtrimet laboratorike janë të obligueshme.

Litaratura shitesë dhe bibliografia:

Cilado literaturë që trajton mikroprocesorët dhe mikrokontrollerët e cilido prodhues është e mirëseardhur.

Modeli i Planit mësimor të lëndës

Syllabusi

Universiteti i Prishtinës

Departamenti/Fakulteti/Njësia akademike: Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike

Titulli i kursit (lëndës mësimore): Sistemet operative

Niveli dhe lloji i kursit: Bachelor /obligative

Viti i studimeve dhe semestri: III, semestri 5

Kodi ose shifra e lëndës:

Vlera në kredi ECTS : 6

Koha/lokacioni (termini i mbajtjes së ligjëratës dhe salla): E mërkure 08.15, salla 616

Mësimdhënësi i kursit:

Emri: Dr Alban Rrustemi

Mobile: 049 464831

Email: alban.rrustemi@cl.cam.ac.uk

Qëllimet e kursit(modulit):

Njohja me bazat e ndertimit modern të sistemeve kompjuterike. Njohja me rolin dhe qëllimet e sistemeve operative. Shtjellim i hollësishëm i detyrave dhe shërbimeve të sistemeve operative.

Rezultatet e pritura të nxënies

Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti duhet:

1. Të zotërojë njohuri themelore mbi ndërtimin dhe veprimin e sistemeve kompjuterike,
2. Të ketë njohuri themelore mbi rolin dhe shërbimet e sistemeve operative, sidhe të jetë në gjendje të ilustroj aspekte themelore të sistemeve operative me shembuj konkret
3. Të ketë njohuri për rolin e sistemit operativ ne menaxhimin e proceseve, menaxhimin e memories, menaxhimin e I/O sidhe resurseve tjera

Sistemet Operative

Faqe 2 prej 4

4. Te ketë njohuri krahasuese te dy sistemeve operative bashkëkohore: Windows dhe Linux

Metodologjia e mësimdhënies: ligjërata dhe ushtrime laboratorike

Literatura bazë :

Autori Titulli

Andrew S. Tanenbaum Modern operating systems

Silberschatz, Galvin,

Gagne

Operating System Concepts

Bacon, Harris Operating Systems

Plani i detajizuar i mësimit për një semestër:

Blloku i parë – Paraqitja dhe objektivat e lëndës: Hyrje në sisteme operative. Një vështrim i shkurtë i sistemit hardverik: Struktura dhe organizimi i CPU-së dhe memories.

Blloku i dytë – Ndërlidhja e hardverit dhe softverit: Një paraqitje e shkurtë e “MIPS ISA”. Menaxhimi i ekzekutimit të instruksioneve në prani të “interrupts”.

Blloku i tretë – Struktura e përgjithshme e sistemeve kompjuterike: Roli i sistemeve operative. Përdorimi i interrupts nga sistemet operative. Përdorimi i I/O-së nëpërmjet sistemeve operative. Mbrojtja e resurseve kompjuterike (CPU, memorie, I/O).

Blloku i katërt – Proceset: Koncepti i proceseve. Menaxhimi i proceseve nga sistemi operativ. Komunikimi në mes të proceseve.

Blloku i pestë – Threads: Koncepti i threads (fijeve). Motivimi dhe përparësitë e shfrytëzimit të threads. Shembuj të implementimit të threads nga disa sisteme operative.

Blloku i gjashtë – Sinkronizimi i proceseve: “Race conditions”. Pjesët kritike të programit. Algoritmi i Peterson-it, Lamport-it. Semaforët, “mutex” dhe monitorët.

Blloku i shtatë – Menaxhimi i resurseve gjatë shfrytëzimit paralel: Probleme klasike në IPC: “The reader/writer’s problem”, “The sleeping barber’s problem”, “The dining philosopher’s problem”. Bllokimet (Deadlocks) dhe qasja ndaj ketij problemi. Livelocks.

Blloku i tetë – Ndërtimi i orarit të ekzekutimit të proceseve: Cikli CPU / I/O.

Ekzekutimi paralel i shumë proceseve. Algoritmet për ndërtim orarësh: FCFS, SJF, RR. Shembuj të implementimit të orareve nga Solaris 10, Windows dhe Linux.

Blloku i nëntë– Menaxhimi i memories: Adresimi i programeve në memorie. Mbrojtja e memories. Efikasiteti në menaxhim të memories: “Paging” dhe segmentimi.

Sistemet Operative

Faqe 3 prej 4

Blloku i dhjetë– Memoria virtuale: “Demand paging”. Zevendesimi i faqeve – algoritmet: NRU, FIFO, Clock, LRU, etj. Shpërndarja e kornizave.

Blloku i njëmbëdhjetë – Sistemi i fajllave: Koncepti i fajllit. Veprimet me fajlla. Organizimi i fajllave – struktura e direktoriemeve. Mbrojtja e fajllave. Kontrollimi i qasjes.

Blloku i dymbëdhjetë – Implementimi i sistemit të fajllave: Struktura e sistemit të fajllave. Particionet dhe montimi. Sistemet virtuale të fajllave. Implementimi i direktoriemeve. Metodot e alokimit. Menaxhimi i hapësirës së lirë. Performansa. NFS.

Blloku i trembëdhjetë – Mass-storage: Struktura e disqeve magnetike. Ndërtimi i orarit të qasjes së diskut: FCFS, SSTF, SCAN, C-SCAN, LOOK. Menaxhimi i disqeve. Menaxhimi i “swap-space”. RAID. Sistemet tjera për ruajtjen e shënimeve voluminoze.

Blloku i katërbëdhjetë – Menaxhimi i I/O: Vështrim krahasues në: “polling”, “interrupts” dhe DMA. Komunikimi i proceseve me I/O. Pajisje të ndryshme. Kernel I/O subsystem. Transformimi i I/O në veprime në hardver. Streams në Unix.

Blloku i pesëmbëdhjetë – Sistemet e distribuara: Përparësitë e sistemeve të distribuara. Llojet e sistemeve të distribuara. Llojet e rrjetave. Emërtimi. Protokolet e komunikimit. Koordinimi i distribuara. Sinkronizimi i kohës në sisteme të distribuara.

Blloku i gjashtëmbëdhjetë – Sistemet kompjuterike me shumë procesorë: Aspekte

hardverike. Ndryshimet në sisteme operative. Sinkronizimi dhe orari i sistemeve me shumë procesorë. Struktura e memories në sisteme me shumë procesorë.

Bloku i shtatëmbëdhjetë - Mbrojtja dhe siguria në sisteme operative: Domenet e mbrojtjes. Matrica e qasjeve. Siguria e sistemeve. Autentikimi i shfrytëzuesve.

Kërcënimet ndaj programeve dhe sistemit. Sistemet e sigurisë. Kriptografia.

Bloku i tetëmbëdhjetë - Virtualizimi: Makinat virtuale. Monitori i makinave virtuale. Virtualizimi i resurseve hardverike. Migrimi i sistemeve operative. Cloud computing.

Bloku i nëntëmbëdhjetë – Studim në Windows: Menaxhimi i proceseve, memories dhe I/O në Windows. NTFS. Siguria në Windows.

Bloku i njëzetë – Studim në Linux: Menaxhimi i proceseve, memories dhe I/O në Linux. NFS. Ext3. Siguria në Linux.

Sistemet Operative

Faqe 4 prej 4

Vërejtje: terminin e vlerësimeve intermediere e cakton mësimdhënësi sipas planifikimit të lëndës që e ligjëron.

Metodat e vlerësimit:

1. Vijimi dhe aktiviteti gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve: 10 pikë (5 për ligjërata + 5 për ushtrime).

2. Testi me shkrim – testi: 100 pikë

Totali (max): 110 pikë

Për të kaluar provimin:

- Minimum nga vijimi 25%, pra 3 pikë
- Minimum nga testi 25%, pra 25 pikë, dhe
- Shuma nga pika 1 dhe 2 duhet të jetë më e madhe se 28 pikë

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes: (mësimdhënësi cakton kriteret për vijimin e rregullt në ligjërata dhe ushtrime dhe rregullat e mirësjelljes si: mbajtja e qetësisë në mësim, shkyqja e telefonave celular, hyrja në sallë me kohë, etj.)

Litaratura shtesë dhe bibliografia: Nuk ka



Syllabusi

Universiteti i Prishtinës

Departamenti/Fakulteti/Njësia akademike: Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike

Titulli i kursit (lëndës mësimore): Inxhinieria softuerike

Niveli dhe lloji i kursit: Bachelor /obligative

Viti i studimeve dhe semestri: III, semestri 5

Kodi ose shifra e lëndës:

Vlera në kredi ECTS : 6

Koha/lokacioni (termini i mbajtjes së ligjëratës dhe salla): E mërkure 08.15, salla 616

Mësimdhënësi i kursit:

Emri: Dr. techn Blerim Rexha, Prof. Ass.
Mobile: 044-627251,
Email: blerim.rexha@fiek.uni-pr.edu,
Termini për student: E mërkure 09.30 -10.30

Qëllimet e kursit(modulit):

Njohja me hapat dhe masat që duhet të ndërmerren për zhvillimin e sistemeve softuerike me kosto efektive dhe të kualitetit sa me të lartë.

Rezultatet e pritura të nxënies

Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti duhet:

1. Të zotërojë njohuri themelore mbi proceset softuerike,
2. Të ketë njohuri themelore mbi modelet e proceseve softuerike,
3. Të jetë në gjendje t'i aplikoj modelet softuerike te ndryshme,
4. Të ketë njohuri themelore mbi koston e zhvillimit te sistemeve softuerike në praktikë,
5. Të jetë në gjendje të bëjë menaxhimin e projekteve softuerike

Metodologjia e mësimdhënies: ligjëratë, seminar dhe ushtrime numerike

Literatura bazë :

Autori

Ian Sommerville

Titulli

Software Engineering, 8th Edition 2007

Roger S. Pressman

Software Engineering, A Practitioner's Approach, 2007

Plani i detajizuar i mësimit për një semestër:

Java e parë - Hyrje në inxhinieri softuerike: Inxhinieria e sistemeve softuerike, Përgjegjësia etike dhe profesionale, Organizimi, njerëzit dhe sistemet kompjuterike.

Java e dytë - Proceset softuerike: Modelet e proceseve softuerike, Proceset me përsëritje dhe përfaqsim, Aktivitetet gjatë proceseve, Rational Unified Model, CASE.

Java e tretë – Menaxhimi i projekteve: Aktivitetet menaxhuese, Planifikimi i projektit, Aktivitetet kohore, Menaxhimi i riskut, Planifikim për versione, Menaxhimi i versioneve, Veglat softuerike.

Java e katërt – Kërkesat inxhinierike: Kërkesat funksionale dhe jo-funksionale, Kërkesat e shfrytëzuesëve, Kërkesat e sistemit, Specifikimi i ndërfaqëve, Dokumenti mbi kërkesat e softuerit, Studimet e fizibilitetit, Analiza dhe validimi i kërkesave.

Java e pestë - Modeli i sistemeve: Modelet sipas kontekstit, modelet sipas sjelljes, Modeli i shënimeve, Modeli sipas objekteve, Klasat dhe objektet, Dizajni i proceseve të bazuara në objekte.

Java e gjashtë – Dizajni arkitektural: Vendimi mbi dizajnin arkitektural, organizimi i sistemit, Komponentët modulare, Menyrat kontrolluese, Arkitektura referencuese

Java e shtatë – Dizajni arkitektural: Arkitektura me shumë procesorë, Klient-Server arkitektura, Arkitektura e aplikacioneve, Sistemi për procesim të të dhënave, Sistemi për procesim të transaksioneve, Sistemi për procesim të ngjarjeve

Java e tetë – Dizajni i bazuar në objekte: Objektet dhe klasat, Dizajni i një procesi të bazuar në objekte, Dizajnimi i sistemeve operative në kohë reale, Monitorimi dhe kontrollimi i këtyre sistemeve, Dizajnimi i ndërfaqës së shfrytëzuesit (User Interface), Procesi i dizajnit të UI, Analiza e UI, Krijimi i prototipit

Java e nëntë – Zhvillimi i shpejta i softuerit: Metodatat agile, “Extreme Programming”, RAD, Prototipet softuerike.

Java e dhjetë – Ripërdorimi i softuerit: Hapësira për ripërdorim, Mostrat, Gjenerimi automatik i kodit burimor, Kornizat për aplikacione, Ripërdorimi i aplikacioneve, Komponentët dhe modelet e komponentëve, Zhvillimi i sistemeve kritike

Java e njëmbëdhjete: Verifikimi, validimi dhe testimi: Planifikimi i verifikimit dhe validimit, Inspektimi i softuerit, Verifikimi dhe metodat formale, Testimi i softuerit, Testitimi i sistemit, Testimi i komponentëve, Testimi i automatizuar, Siguria.

Java e dymbëdhjete: Menaxhimi: Menaxhimi i njerëzve, Zgjedhja e personelit, Motivimi, Puna ne grupe, Vlerësimi i kostos se softuerit, Produktiviteti, Teknikat per vlerësim, Kohëzgjatja e projektit, Përmirësimi i proceseve

Java trembëdhjete – Teknologjitë aktuale - Inxhinieria për sigurinë e shënimeve: Konceptet elementare te sigurisë, Menaxhimi i rrezikut te sigurisë, Dizajni per siguri, Mbijetueshmeria e sistemit.

Java katërbëdhjete – Teknologjitë aktuale - Inxhinieria softuerike e bazuar në shërbime: Shërbimi si komponent e ripërdorshme, Inxhinieria e shërbimeve, Zhvillimi softuerik i bazuar ne shërbime

Java e pesëmbëdhjete – Analiza e rasteve konkrete ne Kosove: Analiza e projekteve softuerike te dhënë nga organizata te ndryshme ne Kosove.

Vërejtje: terminin e vlerësimeve intermediere e cakton mësimdhënësi sipas planifikimit të lëndës që e ligjëron.

Metodat e vlerësimit:

1. Vijimi i ligjëratave dhe ushtrimeve: 10 pikë (5 ligjërata + 5 pikë ushtrime).
2. Pjesës praktike – detyrat e shtëpisë: 40 pikë.
3. Pjesës me shkrim – testi: 50 pikë

Totali (max): 100 pikë

Pjesa me shkrim – testi: 50 pikë

Testi ka 25 pyetje dhe vlerësimi bëhet si vijon:

- Përgjigja e saktë: +2 pikë,
- Përgjigja e gabueshme: -1 pikë
- Pa përgjigje: 0 pikë

Për të kaluar provimin:

- Minimum nga vijimi 25%, pra 3 pikë
- Minimum nga pjesa praktike 25%, pra 10 pikë
- Minimum nga testi 25%, pra 13 pikë, dhe
- Shuma nga pika 1, 2 dhe 3 duhet te jetë më e madhe se 49 pikë

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes: (mësimdhënësi cakton kriteret për vijimin e rregullt në ligjërata dhe ushtrime dhe rregullat e mirësjelljes si: mbajtja e qetësisë në mësim, shkyqja e telefonave celular, hyrja në sallë me kohë, etj.)

Litaratura shtesë dhe bibliografia: Nuk ka.



UNIVERSITATI I PRISHTINËS
UNIVERSITAS STUDIORUM PRISHTINIENSIS

Syllabusi

Departmenti/Fakulteti/Njësia akademike:

Departamenti i Kompjuterikës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike

Titulli i kursit (lëndës mësimore) :

Programimi në Internet

Niveli dhe lloji i kursit:

Bachelor/obligative

Viti i studimeve dhe semestri:

Viti III-të, Semestri VI

Numri i orëve në javë:

2+2+0

Kodi ose shifra e lëndës:

Vlera në kredi ECTS:

5

Koha/lokacioni:

E martë 9:00 – 11:00, Salla 616

Mësimdhënësi i kursit:

Dr. Ing. Lule Ahmedi

Zyra 614 / tel. +381 38 554896 /ext. 237, ose ext. 102 / lule.ahmedi@fiek.uni-pr.edu

Orari i konsultimeve:

E hënë 11:00 – 12:30, E martë 11:00 – 12:30

Qëllimet e kursit(modulit):

Që studentët të aftësohen të kuptojnë konceptet themelore në lidhje me paradigmat programuese gjithnjë aktuale në Internet, si dhe të ofrojnë eksperiencë në dizajnimin dhe implementimin e sistemeve të bazuara në Ueb.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që:

1. Të demonstroj njohuri fundamentale mbi teknologjitë tradicionale dhe atyre aktuale në World Wide Web.
2. Të zhvilloj Ueb aplikacione në praktikë - paraprakisht të përzgjedh arkitekturën, modelin dhe teknikat manipuluese të të dhënave që përkasin me natyrën e aplikacionit të cilin ai zhvillon.
3. Të dalloj përparësitë dhe të metat e paradigmës klient/server ndaj paradigmave tjera të shpërndarjes së komponenteve softverike në Ueb.

Metodologjia e mësimdhënjes:

Ligjërata, punime projektsh në grupe, prezentime, dhe ushtime.

Literatura bazë:

PHP and MySQL Web Development prej Luke Welling, Laura Thompson

JavaScript: The definitive guide prej David Flanagan.

Plani i detajizuar i mësimit për një semestër:

Java e parë:

Hyrje në sistemet klient/server

Java e dytë:

HTML standardi

Java e tretë:

Cascading Stylesheets (CSS)

Java e katërt:

Gjuha skriptuese JavaScript dhe Modeli DOM

Java e pestë:

JavaScript (vazhd.)

Java e gjashtë:

Gjuha skriptuese PHP

Java e shtatë:

Konceptet themelore në PHP (vazhd.)

Prezentimet pjesa e parë: Projekti në JavaScript

Java e tetë:

PHP dhe bazat e të dhënave në MySQL

Java e nëntë

PHP dhe shprehjet e rregullta

Java e dhjetë:

PHP dhe kontrollat e sesioneve

Java e njëmbëdhjetë:

PHP dhe aspektet e sigurisë

Java e dymbëdhjetë:

Konceptet e avansuara në PHP

Java e trembëdhjetë:

Konceptet e avansuara në PHP (vazhd.)

Java e katërmbëdhjetë:

Sistemet e distribuara: CORBA

Java e pesëmbëdhjetë:

Temat aktuale në fushën e programimit në Internet

Prezentimet pjesa e dytë: Projekti në PHP dhe MySQL

Provimi final

Metodat e vlerësimit:

Projekti pjesa e parë/prezentimi: 15%

Projekti pjesa e dytë/prezentimi: 15%

Provimi: 70%

Vijimi i rregullt: I obligueshëm

Total 100%

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Ueb Shërbimet

Ligjërues:

Dr. techn. Blerim Rexha, Prof. Ass.

E-mail: blerim.rexha@fiek.uni-pr.edu

Përshkrimi dhe qëllimi i ligjëratave:

Njohja me XML, .NET arkitekturen e Microsoft-it, Java Teknologjinë, Ueb Shërbimet si dhe aplikimi i tyre në rast konkret. Pas mbarimit të këtijë kursi, studenti duhet:

- të zotërojë njohuri themelore mbi XML dhe XML shemat,
- të zotërojë njohuri themelore mbi .NET arkitekturën e Microsoft-it, CLR, assemblies si dhe gjuhën programuese C#,
- Java teknologjinë,
- të zotërojë njohuri themelore mbi Ueb Shërbimet, dhe protokollet SOAP, WSDL, DISCO dhe UDDI.
- të jetë në gjendje t'i shfrytëzoje Ueb Shërbimet në aplikacione në mënyrë programore,
- të zotërojë njohuri themelore mbi programim e shpërndarë.

Fondi i orëve:

2 orë ligjërata dhe 2 orë ushtrime laboratorike, gjithsejtë 4 orë. Numri i kredive sipas ECTS 5.0 .

Parakushtet e domosdoshme:

Nuk ka.

Parakushtet e dëshiruara:

Njohuri themelore nga një gjuhë programuese (C, C++, C#, Java, Visual Basic, etj.). Përvojë elementare me Developer Studion e Microsoft-it dhe Eclipse

Përmbajtja e ligjëratave:

1. **XML:** Hyrje në XML, Përdorimi i XML, Struktura e XML dokumentit, XML shemat.
2. **.NET Architecture:** Hyrje në .NET, Intermediate Language, Assemblies, .NET framework-u, Krijimi i .NET aplikacioneve me gjuhën programuese C#.
3. **Hyrje në Ueb Shërbimet:** Historiku i programimit të shpërndarë, Web Service protokollet (SOAP, WSDL, DISCO, dhe UDDI), Përparia e Web Service-ve.
4. **Krijimi i një Ueb Shërbimi të thjeshtë:** Komponenten e Web Service-ve, IIS, Infrastruktura për Web Service, Testimi i Web Service-ve me anë browser-it standard.
5. **Shfrytëzimi i Ueb Shërbimeve** - Krijimi i një Windows forme, Krijimi i një ASP.NET faqe, Shfrytëzimi i Web Service-ve pre aplikacionet tjera (Office).
6. **Struktura e SOAP, WSDL dhe DISCO protokoleve:** SOAP komponentet, Struktura e WSDL protokolit, Zgjerimet lidhëse, Algoritmi DISCO, Struktura e DISCO dokumentit.

7. **Vetitë e Ueb Shërbimeve:** Urdhërat për processim, Vetia “WebService”, Vetia “WebMethod”, Trasferimi i objekteve komplexe.
8. **Interoperabiliteti me COM dhe invokimi i Ueb Shërbimeve në mënyrë asinkrone:** COM dhe Web Services, Funksonet asinkrone, Callbacks vs. Waithandles
9. **Ueb Shërbimet dhe siguria në .NET:** Nivelet e sigurisë (Rrjetës, Transportues, Aplikacion), Pasqyrë e sigurisë në .NET, Vegla softverike për siguri.
10. **Web Service Enhancements (WSE):** Zgjerimi i XML Ueb Shërbimeve, Hyrje në WSE, Shtimi çertifikates së sigurisë në SOAP mesazhin, Nënshkrimi digjital i SOAP mesazhit.

Ushtrimet:

1. Shkruarja e një XML dokumenti dhe XML sheme me vegla standarde (p.sh me notepad.exe) si dhe .NET Developer Studio.
2. Shkruarja e një Ueb Shërbimi matematikor të thjeshtë në gjuhën C# duke e përdorur .NET Developer Studio.
3. Shkruarja e një aplikacioni të thjeshtë që konsumon Ueb Shërbime.
4. Shkruarja e një aplikacioni të thjeshtë në gjuhën C# që i invokon metodat e Ueb Shërbimeve në mënyrë asinkrone si dhe përdorimi i attributeve të Ueb Shërbimeve.
5. Shkruarja e një Ueb Shërbimi të thjeshtë në gjuhën C# që i përdorë WSE.

Detyrat e shtëpisë:

1. Të shkruhet XML shema për shënime të pacientëve.
2. Të shkruhet ueb shërbimi që i eksporton shënimet e pacientëve prej një SQL baze të shënimeve.
3. Të shkruhet ueb shërbimi matematikor që i përdorë nënshkrimet digjitale dhe X.509 certifikatat.

Literatura:

<i>Autori</i>	<i>Titulli</i>
Robert Tabor	Microsoft .NET WML Web Services, ISBN: 0-672-32088-6, Sams Publishing, 2002
Ashish Banerjee and group of authors	C# Web Services, ISBN: 1-861004-7, Wrox Press, 2001
Bill Evjen	Web Service Enhancements, ISBN: 0-7645-3736-9, Wile Publishing, 2003
William R. Stanek	XML – Pocket Consultant ISBN: 0-7356-1183-1, Microsoft Pres, 2002

